



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 260, Datë 21.12.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BREÇANI R.O.S.P”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “DRITA” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar ; dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes nr. 156/1 prot, datë 15.12.2021, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita” me kapacitet të instaluar 1980 kW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135 prot., datë 10.12.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita”, me vendodhje në lumin e Gashit, degë e lumit Valbonë, bashkia Tropojë, Qarku Kukës.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. neni 9, pika 2, gërmat “c”, “f”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal. neni 9, pika 3, gërmat “b” dhe “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni teknik për HEC-in. neni 9, pikat 4.1.1; dhe pika 4.1.4, gërmat “b” dhe “e”. **Plotësuar.**
  - Leje nga institucione të tjera. neni 9, pika 4.1.5, gërma “a”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar, ka të bëjë me:

**Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:**

- **gërmat “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti), **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., duhet të depozitojë në ERE Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.**  
**Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, Vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vetë shoqërinë. Nisur nga fakti që kjo shoqëri ushtron veprimtari në Kukës dhe në Durrës, duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për administratorin dhe vetë shoqërinë edhe për këto qarqe.**
- **gërma “e”** (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik. **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE Licencën për drejtuesin teknik elektrik.**
- **gërma “g”** (Dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme,etj.); **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë të plotë dhe në formën ligjore dokumentacionin pronësor që disponon mbi truallin ku do të ndërtohet HEC “Drita”.**

**Dokumentacioni financiar dhe fiskal. neni 9, pika 3:**

- **gërma “a”** (Vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet**

të depozitohet në ERE vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **gërma “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera), **Plotësuar pjesërisht.**  
Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacionin financiar mbështetës në vijim të deklaramentit të saj se kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti është 50.000 (pesëdhjetë mijë) Eur/Vit.

#### **Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin. neni 9, pika 4.1.2. Plotësuar pjesërisht.**

Shoqëria duhet të bëjë me dije llojin e Skemës së lidhjes së përshtjellave.

#### **Dokumentacioni teknik dhe grafik. neni 9, pika 4.1.3**

- **gërma “a”**: Paraqitjen e përgjithshme skematike të centralit në format A1 – **Pa plotësuar.**
- **gërma “b”**: Një diagrame elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes. **Pa plotësuar.**
- **gërma “c”**. Shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakto (numër parcele, numër rregjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1: 25000. **Pa plotësuar.**
- **gërma “d”**. Një hartë topografike ku të praqitet gjurma e linjës transmetuese në shkallë 1: 25000 – **Pa plotësuar.**

Sa më sipër shoqëria duhet të përcjellë në ERE sa kërkon kjo pikë e rregullores.

#### **Dokumentacioni tekniko-ekonomik. neni 9, pika 4.1.4**

- **gërma a.** Studimi i fizibilitetit. **Pa plotësuar.**  
Shoqëria duhet të depozitohet në ERE Studimin e Fizibilitetit.
- **gërma “c”**. Oponenca teknike e projektit – **Plotësuar pjesërisht.**  
Shoqëria duhet të depozitohet në ERE Raportin e Oponencës Teknike nr. 4359/5 prot., datë 09.07.2018, mbi Projektin e Zbatimit të HEC “Drita”, si dokument të plotë, pasi mungojnë konkluzionet e Grupit të Oponencës Teknike.
- **gërma “d”**. Plani i biznesit: **Pa Plotësuar.**  
Shoqëria duhet të depozitohet në ERE Planin e Biznesit.

### **Leje nga institucione të tjera. neni 9, pika 4.1.5.**

- **gërma “b”**. Leja e përdorimit të ujit – **Plotësuar pjesërisht.**

**Duke qenë se Autorizimi për përdorim të burimit ujq është dhënë me afat deri në datën 12.06.2019 (afat i cili ka përfunduar), shoqëria duhet të na bëjë me dije nëse është pajisur me Leje për përdorimin e burimit ujq dhe nëse po, ta depozitojë atë në ERE.**

- **gërma c**. Leja Mjedisore – **Pa plotësuar.**

**Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Lejen Mjedisore.**

Shoqëria do të njoftohet që në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar të paraqesë dokumentacionin e sipërcituar brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**